



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____12.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Certifikimi i sigurise ISO 27001:2022 dhe implementimi i tij në Albpetrol sh.a”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): [79130000-4](#) Shërbime të dokumentimit dhe certifikimit ligjor,

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,916,666 (Katër milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës3;
 - b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendorsja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1. Shërbime te mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi per pervojen e meparshme kerkohen te paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendorsja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik ka eksperiencë të ngjashme me objektin e prokurimit.

- 2.3.2. Certifikatë ISO 9001:2015 ose e perditesuar (per sistemet e menaxhimit te cilesise), e vlefshme, e operatorit ekonomik, ose ekuivalente, leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme eshte përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të kësaj kërkesë AK kërkon të sigurohet që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat e menaxhimit cilësisë dhe ky kriter i vendosur është në përputhje të plotë me objektin e prokurimit.

- 2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ISO 27001:2022 ose e përditësuar, ose ekuivalente me të për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme eshte përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të kësaj kërkesëve AK kërkon të sigurohet që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin

dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat e menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe ky kriter i vendosur është në përputhje të plotë me objektin e prokurimit.

2.3.4. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontrates, duhet të ketë staf teknik minimalisht 6 (gjashtë) punonjes. Për këtë të paraqitet:

- Vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për të paktën tre muajt e fundit.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesat për punonjës janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) person të diplomuar për inxhinieri IT/Elektronike/Elektrike dhe me kualifikime apo trajnime të ndryshme mbi standardet ISO 27001 apo Cybersecurity.:

Për këtë të paraqiten:

- Diploma e arsimit të lartë.
- Certifikata përkatëse e lëshuar nga organi kompetent.
- Listëpagessat e shoqërisë për tre muajt e fundit, në të cilat inxhinieri i cituar duhet të figurojë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesat për punonjës janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Kërkesa për inxhinierin është në përputhje me standartet dhe kërkesat për sigurinë e informacionit në IT.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) konsulent Ekspert/ Drejtues Ekipi që të vërtetojë që angazhohet, është i kualifikuar dhe ka eksperiencë në hartimin e dokumentacionit, implementimit dhe asistencës për standardet ISO 27001. Eksperti i sipërcituar duhet:

Të ketë përvojë si implementues dhe auditues në hartimin, zhvillimin, mirëmbajtjen e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit sipas standardeve ISO/IEC-27001;

Eksperiencë në sistemet e informacionit dhe infrastrukturën mbështetëse të tyre (aplikacione, operacionet, infrastruktura dhe menaxhimi);

Eksperienca në pozicione të ngjashme në Qeverisjen e TIK/Auditimin e TIK në auditim të brendshëm ose organizma të jashtme auditimi;

Për këtë të paraqiten:

- Certifikata ISO 27001:2022 si Lead Auditor ose Lead Implementer/ ose ekuivalente me të, (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- CV
- Listëpagessat e shoqërisë për muajin e fundit, në të cilat konsulenti Ekspert/ Drejtues Ekipi duhet të figurojë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesat për punonjës janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kërkesa për stafin e kualifikuar të kërkuar, behet me qëllim përmbushjen e kontratës, sipas përshkrimit të bere ne Termat e References. Konsulenti i kërkuar do të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm, dhe do të beje trajnimet e nevojshme, ne përmbushje të kërkesës se Termave të References.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit: